



Perspektiva juaj
është sfida jonë!

Fondi më i ri në fushën e investimeve

Raport Muaji Tetor 2021

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	20 Gusht 2018
Datë e mbarimit te Ofertes Fillestare	03 Shtator 2018
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	30,000
Shuma minimale pasuese	10,000
Komision në hyrje	0%
Komision në dalje	2% (cdo shlyerje para 2 viteve)
Komision Administrimi në vit	1.25%
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizoje kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.


Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emtuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsye, fondi investon të paktën 50 – 80% të aseteve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Profili i parashikuar i Rrezikut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë.

Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit.


Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31.10.2021

Vlera Neto e Aseteve	16,750,739,597
Numri i investitoreve	5,901
Cmimi i Kuotes	1,119.1265
*Kthimi nga investimi (31.10.2020 – 31.10.2021)	4.22%

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 31 Tetor 2021



Ne kuader të politikës së investimit të fondit Vizion, investimet kryhen kryesisht në obligacione thesari, të emtuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar dhe transaksioneve në tregun sekondar.

Politika e investimit parashikon që të paktën 50 – 80 % e asetëve të fondit të investohen në obligacione afatgjate të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Bonot e thesarit 12 mujore emtohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here në 2 muaj për secilin maturitet.

Instrumenti	Ne % të Aseteve të Fondit
Bono Thesari	3.10%
Obligacione Thesari	80.05%
Depozita / Llogari rrjedhese / Te arketueshme	14.02%
Marreveshje të Anasjellta të Riblerjes – Rev Repo	2.83%

Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 16.75 miliardë në datë 31 Tetor 2021.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Tetor

Situata e krijuar nga rritja e numrit të infektiveve si pasoje e variantit Delta, së bashku me rritjen e çmimeve të energjisë, naftës dhe gazit, gjithashtu mungesat në zinxhirin e furnizimit dhe në fuqinë puntore, kontribuan në një ngadalësim të rritjes ekonomike në nivel global, gjatë tremujorit të tretë të këtij viti.


Situata shëndetësore në Shqipëri vazhdon të jetë kritike me përhapjen e variantit Delta, edhe pse numri i të infektuarëve është ulur në krahasim me muajin Shtator, nga ana tjetër procesi i vaksinimit vazhdon të kryhet me ritme të shpejta.

Asetet e Fondit Vizion janë të investuara vetëm në bono dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e interesit të këtyre titujve. Kështu investimet e fondit nuk kanë lidhje direkte me tregjet ndërkombëtare, por impaktohen kryesisht nga zhvillimet në tregun e brendshëm sic janë ndryshimet në normat e interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare.

Përgjatë muajit Tetor në tregun vendas normat e interesit të titujve të emetuar nga Qeveria Shqiptare patën një trend mikës. Yield-i i Bonos së Thesarit 12-mujore rezultoi në 1.696% duke rënë 0.07% në krahasim me ankandin e muajit Shtator. Yield-i i Bonos 3 mujore rezultoi në 1.003% duke u rritur me 0.07% në krahasim me ankandin e fundit.

Për sa i përket obligacioneve, ankandi i rihapur i obligacionit 2 vjeçar-i i emetuar në LEK rezultoi në 2.20%, i pandryshuar në krahasim me normën e ankandit paraardhës. Ankandi i obligacionit 10-vjeçar i cili rezultoi në 5.20% duke u rritur me 0.20% krahasuar me ankandin e fundit të organizuar në Korrik. Gjithashtu u zhvillua edhe ankandi i obligacionit reference 3-vjeçar i cili rezultoi në 2.577%, duke rënë me 0.04% krahasuar me ankandin e fundit të muajit Gusht.

Grafiku me poshtë jep një pasqyrë të ecurisë së normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të thesarit të emetuar nga Qeveria Shqiptare gjatë periudhës 1-vjeçare Tetor 2020 – Tetor 2021. Për obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare janë paraqitur yields fikse të përlogaritura nga kuotimet e kontributoreve në fund të muajit Tetor.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 31 Tetor 2021

Fondi Vizion ka patur një performancë pozitive, çmimi i kuotës është rritur lehtë me **+0.03%** gjatë muajit Tetor.

Ndërsa kthimi me baze vjetore, për periudhën 31 Tetor 2020 – 31 Tetor 2021 është 4.22%.

Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varesi të kushteve të tregut, sic janë ndryshimet e normave të interesit të titujve të borxhit të emetuar nga Qeveria Shqiptare. Kështu kur normat e interesit në treg rriten, vlera e titujve të portofolit ulët dhe për rrjedhojë ulët dhe norma e kthimit për periudhën e kaluar. E kundërta ndodh kur normat e interesit ulen.

Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatshmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.



Fondi Vizion aplikon nje periudhe minimale qendrimi ne fond prej 2 vitesh. Cdo shlyerje perpara permbushjes se periudhes 2-vjet, do te jetë subjekt i nje tarife dalese prej 2% e vleres se kuotave te shlyera.

Pertej minimumit kohor te qendrimit ne fond, Investitoret e fondit Vizion dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Per fondin Vizion ky horizont i rekomanduar i qendrimit ne fond eshte te pakten 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe ne menyre qe te permbushet objektivi i performancës së fondit. Investitoret inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithe shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë nje kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.